

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Arsimit dhe Sportit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza zhvillimit
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare e Arsimit, 2021-2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	26.10.2022 - 22.11.2022
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 16.12.2022
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2023- MAS- Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Ardjana Gjini Ardjana.gjini@arsimi.gov.al Florian Nurçe, Florian.nurce@arsimi.gov.al Besnik Rama Besnik.Rama@arsimi.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Ligji aktual në fuqi trajton parimet bazë të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i ligjit është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.	

Problemi që merret në shqyrtim lidhet me faktin që disa përcaktime të ligjit aktual nuk janë të qarta mjaftueshëm dhe ka vakum ligjor gjatë zbatimit të tij. Për këtë arsye, është e nevojshme përmirësimi i vazhdueshëm i ligjit aktual në fuqi për arsimin parauniversitar, duke plotësuar mangësitë e hasura gjatë zbatimit të tij, si dhe riformulimi i disa dispozitave ligjore, në kuadër të propozimeve të bëra nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në funksion të qartësisë që duhet të kenë përcaktimet ligjore.

Konkretisht në ligjin aktual nuk është e qartë dispozita ligjore për klasat artistike në shkollat 9-vjecare ku ato kanë funksionuar ndër vite. Gjithashtu, në institucionet e arsimit parauniversitar ka pasur pranime në klasën e parë të fëmijëve që mbushin moshën 6 (gjashtë) vjeç brenda vitit kalendarik, pavarësisht përcaktimit ligjor për fillimin e klasës së parë.

Gjithashtu disa problematika të tjera të evidentuara janë edhe:

- ✓ mosfunksionimi efektiv në praktikë i shkollave të bashkuara. Mungesa e parashikimeve ligjore për funksionimin efektiv të shkollave të bashkuara, të cilat janë institucione arsimore parauniversitar publike, që përfshijnë nxënës të disa niveleve arsimore.
- ✓ mungesa e parashikimeve ligjore për funksionimin e shkollave të arsimit special, ka çuar në mosfunksionimin efektiv të qendra burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara;
- ✓ niveli pamjaftueshëm i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara;
- ✓ mungesa e një parashikimi ligjor që ndalon personat që janë dënuar për vepra penale, që lidhen me të miturit, ose vepra penale që lidhen me institucionet arsimore parauniversitare, ose që figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Dënuarve për Krime Seksuale, për të ushtruar profesionin e mësuesit apo për të punuar, në institucionet arsimore parauniversitare, le të hapur mundësinë e punësimit të këtyre personave në sistemin arsimor parauniversitar, etj.

Ndryshimet e propozuara nëpërmjet kësaj nisme do të mundësojnë adresimin e disa aspekteve që ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e sistemit arsimor parauniversitar.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme pasi do të sjellë përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar, do të krijojë kushte të përshtatshme për garantimin e sigurisë dhe interesit më të lartë i fëmijës, si dhe do të sigurojë mbështetje institucionale për komunitetin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Garantimi i mirëfunksionimit dhe efikasitetit të shkollave të bashkuara, të cilat janë institucione arsimore parauniversitare publike, që përfshijnë nxënës të disa niveleve arsimore, brenda vitit 2024.

- Garantimi i të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, si dhe promovimi i talenteve në arsimin bazë nëpërmjet përfshirjes së konceptit të shkollave me status të veçantë.
- Sigurimi i mbrojtjes së nxënësve dhe integritetit të mësuesve, si dhe punonjësve të tjerë që punojnë në institucionet arsimore parauniversitare.
- Garantimi i të drejtës për të ndjekur arsimin bazë edhe nga fëmijët që mbushin moshën 6 vjeç pas fillimit të vitit shkollor, por brenda datës 31 dhjetor të po atij viti kalendarik.
- Garantimi i të drejtës për arsimim cilësor dhe shërbime të specializuara rehabilituese në qendra burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i figurës dhe integritetit të drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor privat, nëpërmjet konfirmimit nga institucioni përgjegjës për licencimin, sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” (duke mosndërrhyrë me amendime të mëtejshme, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri).

Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i një ligji të ri. Ky opsion nuk mund të merret në konsideratë sepse ndryshimet e propozuara prekin më pak se 50% të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, që është aktualisht në fuqi.

Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

Vënia në zbatim e opsionit të preferuar do të shoqërohet me ndikime ekonomike. Miratimi i këtij projektligji pritet të ketë ndikime direkte në buxhetin e shtetit në drejtim të rritjes së shpenzimeve, konkretisht si më poshtë:

1. për rritjen e numrit ekzistues të punonjësve me rreth 50%, si pasojë e krijimit të Qendrave Burimore;
2. për blerjen e mjeteve didaktike mësimore;
3. për trajnimin e personelit mësimor;
4. për blerjen dhe pajisjen me tekste shkollore;

5. për blerjen e pajisjeve laboratorike elektronike & kompjuter;
6. për blerjen e pajisjeve të tjera të specializuara;
7. për rindërtimin sipas standardeve evropiane të institucioneve arsimore parauniversitare.

Aktualisht funksionojnë 9 (nëntë) institucione arsimore që nuk kanë statusin e qendrave burimore ku standardet e mësimdhënies, numri i punonjësve, normat mësimore, punonjësit ndihmës, apo punonjësit psiko-sociale kanë një standard, ashtu si shkollat e tjera. Pas miratimit apo ndryshimeve ligjore këto 9 (nëntë) qendra burimore do të ndryshojnë tërësisht qasjen ndaj mësimdhënies, raportin punonjës – nxënës, norma mësimore, pajisjet e mësimdhënies, trajnimet, etj.

Ky ndryshim do të reflektojë në shtesën numrit të punonjësve ndihmës mësimorë, si dhe punonjës psikosociale në institucionet arsimore, shtesë e cila reflektohet dhe në efektet e pritshme financiare.

Nëse nuk reflektohen këto ndryshime rreth 1000 punonjës mësimorë që aktualisht punojnë si mësues për shkak të uljes së numrit të nxënësve, uljes së numrit të klasave dhe standardeve mësimore duhet të dalin jashtë sistemit, miratimi i ndryshimeve ligjore do të bëjë të mundur shtesën numrit të punonjësve apo ndryshimin e strukturave të personelit mësimor, ndihmës mësimor dhe punonjësve psiko-sociale në këto institucione arsimore. Për këtë arsye janë përlogaritur dhe efektet financiare që do të sjellë ky projektligj.

Konkretisht sqarojmë se për funksionimin e shkollave speciale si “Qendra burimore”, parashikohet kthimi i 9 (nëntë) institucioneve të arsimit special të cituara më sipër në qendra burimore. Në “Qendrat Burimore”, siç është përcaktuar edhe më lart parashikohet të ketë rritje të numrit ekzistues të punonjësve me rreth 50%. Rritja e numrit të punonjësve lind nevojën për shtesë pagash në buxhet për këta punonjës shtesë. Stafi shtesë do të kryejë funksionet e qendrës burimore, vlerësim të nxënësve, shërbime të specializuara rehabilituese, trajnime dhe ndjekje, kujdes të vijuar të nxënësve me aftësi të kufizuara apo aftësi ndryshe në të gjitha institucionet arsimore të vendit. Numri i nxënësve që do të përfitojnë menjëherë drejtpërdrejtë nga krijimi, reformimi i shkollave speciale në qendra burimore është 4700 nxënës. Kjo shifër përfshin nxënësit me aftësi të kufizuara në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar publik, arsim special dhe gjithëpërfshirës. Çdo vit parashikohet një rritje mesatarisht me 5% e këtij numri të nxënësve. Me ngritjen e qendrave burimore parashikohet të ketë rritje të numrit të klasave që kanë shkollat speciale, si dhe mundësia për të vijuar arsimin e mesëm të lartë në këto institucione.

Në përlogaritjen e kostos vjetore rritja mesatarisht me 5% e nxënësve që do të ndjekin këto shkolla specifike, ndaj vitit paraardhës nuk është marrë në konsideratë, pasi fondet e kursyera sipas ndryshimeve strukturore do të mbulojnë kostot e shtuara në këto nëntë institucione apo qendra burimore të krijuara. Pra, këta nxënës që pas vlerësimit do të kalojnë nga sistemi masiv arsimor në qendrat burimore do të krijojnë burime njerëzore dhe financiare “të lira” për tu rishpërndarë drejt këtyre qendrave.

- Nevojat për laboratorë, pajisje dhe mjete didaktike shtesë për 2 (dy) institutet vitin e parë do të mbulohen nga projekti IPA 2018. Në vijim do parashikohen nevojat vit pas viti. Sipas tavaneve buxhetore të miratuara do të financohen hap pas hapi nga fondet e

buxhetit të shtetit.

Vlera e miratuar për projektin sipas Kontratës “IPA 2019/AL/I Projektit EU 4 Inclusive Teaching”, për katër objektivat e projektit është 2,352,941.19 Euro. Objektivi nr. 4 i projektit është “*Bashkëpunimi për hartimin e një plani tranzicioni drejt krijimit të Qendrave Burimore dhe ndërtimin e kapaciteteve për lehtësimin e zbatimit të këtij plani*”, por duke qenë se në kontratë nuk ndahet në mënyrë specifike se sa është shuma për secilin objektivi, nuk mund të kemi një shumë të detajuar për objektivin 4. (Kontrata është nënshkruar nga MFE datë 30.12.2021, Zyra e Delegacionit Europian në Tiranë datë 22.02.2022 dhe zbatohet nga OSFA dhe Universiteti Tampere Finlandë).

- Përlllogaritjet e efekteve financiare të krijimit të 9 (nëntë) institucioneve, në “Qendra burimore”; ku do të përfitojnë rreth 4,700 nxënës e mësues, si dhe mësues ndihmës, do të ketë një kosto financiare me rreth 50% të punonjësve parashikohet të shtohen në këto shkolla dhe më shumë se 1000 punonjës mësimorë, mësimorë-ndihmës, punonjës psiko-socialë me një kosto vjetore të parashikuar për shpenzime personelit, 1,000 punonjësve x 80,000 lekë *12 muaj = 960,000,000 lekë; shtuar dhe sigurimet shoqërore në masën 16.7% = 160,320,000 lekë; Totali 1,120,320,000 lekë në vit.

Sqarojmë, se numri prej 1000 punonjësish mësimorë janë aktualisht në sistem dhe punojnë si mësues ndihmës. Nëpërmjet këtij projektligji synohet që ky numër punonjësish të strukturoren sipas një strukture të veçantë, pra struktura e re e Qendrave Burimore do të ketë tanimë dhe punonjës mësimorë ndihmës, punonjës psiko-socialë, mjek, logopedist, si dhe punonjës apo oficer sigurie. Ristrukturimi apo ndryshimin i strukturës së numrit të punonjësve në institucionet arsimore, Qendra Burimore, nuk do të përbejë kosto të shtuar për buxhetin e shtetit, pasi aktualisht këto punonjës paguhen si mësues dhe pagat e tyre janë të planifikuara në fondet buxhetore. Por, në rast se nuk do të ndërmerret nisma për miratimin e projektligjit, ky numër punonjësish do të detyrohen të dalin jashtë sistemit arsimor.

- Numri i punonjësve i parashikuar si shtesë për qendrat burimore, do të jetë brenda numrit aktual të punonjësve të arsimit para universitar, por do të ndryshohet struktura nga punonjës mësimorë në ndihmës mësimorë, si dhe punonjës psiko-socialë.
- Fonde të parashikuara për blerje e mjeteve didaktike dhe mësimore, për shërbim cilësor në 4,700 nxënës parashikohet të jetë 9,400,000 lekë në vit.

Mjete didaktike konsiderohen mjetet në shërbim të mësuesit dhe mësimdhënies, dhe që i shërbejnë mësuesve në kuadër të zhvillimit të lëndëve të veçanta mësimore (mjete didaktike-mësimore për zhvillimin e mësimimit në lëndën gjuhë shqipe, matematikë, dituri natyre, gjeografi, histori, biologji, fizikë, kimi, edukim fizik, muzikë, etj.). Ndërsa, **mjetet mësimore** janë mjetet personale të secilit nxënë që shërbejnë për përvetësimin e mësimimit dhe plotësimin e detyrave të klasës dhe të shtëpisë (fletore sipas lëndëve matematikë, gjuhë, fletore muzike, fletore vizatimit, fletore punë të ndryshme të pavarura, çanta për librat dhe mjete të punës për nxënësit sipas orëve mësimore, si lapsa, lapustila, plastelina, vizore, kompaste, raportorë, trekëndësja trupa të ndryshëm gjeometrike që përdoren në klasë apo në shtëpi nga nxënësit).

- Fonde të parashikuara për trajnimin e rreth 1000 punonjësve mësimorë ndihmës-mësimorë, punonjës psiko-socialë me një kosto vjetore të shpenzimeve parashikohet të jetë në masën 4,000,000 lekë në vit.

- Fonde të parashikuara, për blerje dhe pajisjen me tekste shkollore, mjete shkollore dhe materiale ndihmës mësimore, përfshirë nxënësit që nuk shikojnë, për 4700 nxënës x 10,000 lekë =47,000,000 lekë.
- Fonde të parashikuara për pagesën e bursave kuotave ushqimore për rreth 4700 nxënës parashikohet një fond 4700 x 6,668 lekë në muaj x 9 muaj =282,057,034 lekë në vit.
- Fonde të parashikuara “Për blerje pajisje laboratorit elektronik & kompjuter të specializuar”, për nxënësit që nuk shikojnë, për nxënësit që nuk dëgjojnë si dhe nxënësit me aftësi ndryshe përfshirë dhe mësuesit, ndihmës-mësuesit si dhe punonjësit psiko-socialë, parashikohet një fond prej 4700 nxënës + 1,000 punonjës mësimorë dhe ndihmës mësimorë x 150,000 lekë = 855,000,000 lekë për 10 vjet, ose 85,500,000 lekë në vit.
- Fonde të parashikuara, “Për ndërtimin-rindërtimin e objekteve arsimore”, dhe pajisjen e mjediseve e mjediseve të institucioneve arsimore sipas standardeve evropiane për një periudhë 9-10 vjeçare parashikohet të jetë 900,000,000 lekë, ose 90,000,000 lekë në vit.

Sa më sipër, sqarojmë se kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, janë konsideruar gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2023-2025 dhe në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2023-2025.

Gjithashtu, në parashikimin e efekteve financiare në 10 vite nuk është konsideruar niveli i ndikimit të inflacionit vjetor, pasi një pjesë e këtij ndryshimi mbulohet nga politika e rritjes së pagave sipas programit të reformave miratuar në Këshillin e Ministrave. Ndërsa për zërat e tjerë të shpenzimeve, efektet shtesë parashikohen të mbulohet nga ndryshimet strukturore të shpenzimeve të parashikuara në arsimin parauniversitar.

Ndikimet sociale

Fusha e arsimit është një nga fushat më të rëndësishme pasi ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi. Ndryshimet e propozuara do të sjellin:

1. rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin para universitar;
2. rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kryesisht në institucionet arsimore para universitare që ofrojnë arsim special dhe shërbime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara (Qendra Burimore);
3. rritjen e numrit të nxënësve që frekuentojnë Qendrat Burimore;
4. zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor në sistemin arsimor para universitar;
5. rritjen e mundësive për ndjekjen e arsimit para universitar nëpërmjet funksionimit të shkollave të bashkuara që përfshijnë nxënës të disa niveleve arsimore;
6. përmirësimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve si pasojë e marrjes së masave të mësipërme;
7. përmirësim i cilësisë së jetës për nxënësit që preken nga ndërmarrja e kësaj politike dhe familjarët e tyre, etj.

Gjithashtu, nëpërmjet arsimit para universitar cilësor, synohet gjithë përfshirje dhe barazi, duke krijuar kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

Në veçanti, krijimi i qendrave burimore do të sigurojë mbështetje institucionale për të gjithë komunitetin të nxënësve me aftësi të kufizuar, pavarësisht llojit të vështirësisë apo institucionit arsimor që kanë përzgjedhur për arsimimin e tyre, me qëllim përgatitjen dhe integrimin e tyre në shoqëri, duke nxitur rritjen e rezultateve akademike nëpërmjet përgatitjes profesionale dhe shërbimeve mbështetëse.

Ndikimet mjedisore

Me ndryshimet e propozuara parashikohet të ketë ndikime mjedisore, nga rindërtimi i institucioneve arsimore para universitare (IAP). Kryesisht rindërtimi i IAP-ve do të sjelli ndikime negative në natyrë dhe mjedis, siç mund të përmendim ndotjen e ajrit, e cila vjen si rezultat i përhapjes së pluhurave që gjenerohen nga materialet e ndërtimit. Megjithatë, duhet theksuar se aktiviteti i përditshëm urban i automjeteve gjeneron ndotje më të madhe se sa përdorimi i mjeteve në kantier.

Një tjetër ndikim mjedisor negativ mund të përmendim zhurmat që do të gjenerohen në mjediset e kantierëve të rindërtimit të IAP-ve, të cilat do të vijnë kryesisht nga mjetet dhe makineritë, si dhe nga proceset e ndryshme të rikonstruksionit, ndërtimit, etj.

Rindërtimi i IAP-ve mund të sjellë edhe ndikime pozitive, ndër të cilat mund të përmendim përmirësimin e peizazhit të zonës.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Në krahasim me opsionet e tjera opsioni 2 i miratimit të ndryshimeve në ligjin aktual, pra ndryshimi i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe me efektiv, pasi vetëm ky opsion do të sjellë përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë. Në krahasim me opsion 1, ky opsion ka më pak kosto.

Nëpërmjet këtij opsioni realizohet zgjidhja në mënyrë thelbësore dhe përmbajtësore e problematikave të evidentuara në fushën e arsimit para universitar gjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi.

Ky opsion do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore që lidhen me arsimin para universitar, si dhe do të kontribuojë në integrimin e Shqipërisë në BE.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

(Në milion lekë)

Financimi	Viti 1_ 2023	Viti 2_ 2024	Viti 3_ 2025
Total			
Buxheti i shtetit	1,665	1,665	1,665
Të pambuluara			

Sqarojmë se kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, janë konsideruar gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2023-2025 dhe në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2023-2025. Këto efekte janë përlllogaritur dhe dërguar në MFE me shkresën nr. 1890/1, datë 02.09.2022, “Relacion mbi kërkesat buxhetore të programit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”, si dhe shkresën nr. 1890/3, datë 02.09.2022 “Kërkesë për fonde shtesë për periudhën afatmesme 2023-2025”.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 19, datë 20.01.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt akteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2022”, i ndryshuar.

Në përbërje të grupit ka përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para universitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para universitar.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik në zbatim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nëpërmjet faqes zyrtare konsultimipublik.gov.al, përkatësisht në datat 06.07.2022 - 26.07.2022 dhe 26.10.2022 - 22.11.2022. Në faqen zyrtare të konsultimit publik nuk ka pasur komente për projektligjin.

Gjithashtu, janë zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para universitar (DPAP), të drejtorive rajonale të arsimit para universitar (DRAP), të zyrave vendore të arsimit para universitar (ZVAP) dhe të institucioneve të arsimit para universitar (IAP), me Këshillin Kombëtar të Arsimit Para universitar, Këshillin Kombëtar të Prindërve dhe Parlamentin e Nxënëseve, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqërinë civile, si dhe nëpërmjet shkresave të përcjella për sugjerime në MAS. Për secilin prej sugjerimeve u diskutua gjatë takimeve dhe u sqaruan ato sugjerime që ishin të reflektuara në legjislacionin në fuqi, si dhe u morën ato sugjerime që ishin propozime të reja. Këto propozime grupi i punës i vlerësoi në raport me politikat e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe efektet financiare për buxhetin e MAS. Një pjesë e sugjerimeve janë marrë në konsideratë, ndërsa disa të tjera nuk janë marrë në konsideratë duke dhënë argumentet përkatës nuk mund të merren në konsideratë në tabelën e konsultimit të projektligjit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar, janë :

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Qendra e Shërbimeve Arsimore;

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para universitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Para universitar;
- Drejtoritë Rajonale të Arsimit Para universitar;
- Zyrat Vendore të Arsimit Para universitar;
- Institucionet arsimore para universitare publike dhe private;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Qendrat Burimore;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Strukturat që ngarkohen drejtpërdrejtë me vlerësimin e efektivitetit dhe të zbatimit të këtij projektligji, janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Qendra e Shërbimeve Arsimore;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është miratuar në vitin 2012 dhe është ndryshuar 2 herë në vitet 2015 dhe 2018, konkretisht nga ligji nr. 56/2015 dhe ligji nr. 48/2018.

Ndryshimet e bëra nëpërmjet ligjit nr. 56/2015, konsistojnë kryesisht në riformulimin e disa përkufizimeve, të qëllimeve të ligjit, të kompetencave themelore të nxënësve, të përcaktimeve në lidhje me arsimin bazë duke përfshirë edhe klasën e nëntë, të përcaktimeve për tekstet shkollore, etj.

Në krahasim me ndryshimet e bëra nëpërmjet ligjit nr. 56/2015, ligji nr. 48/2018, solli më shumë ndryshime, ndër të cilat mund të përmendim:

- Përcaktimet ligjore në lidhje me detyrimi e certifikimit të drejtuesve të institucioneve arsimore para universitare.
- Krijimi i Shkollës së drejtorëve si person juridik që ka si qëllim zhvillimin profesional të drejtuesve dhe kandidatit për drejtues të institucionit arsimor para universitar, publik ose privat, administrimin e procesit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e institucioneve arsimore para universitare dhe të trajnimit të vazhdueshëm të drejtuesve.
- Përcaktimet në lidhje me krijimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, e cila është platformë *online*, ku kandidatët për mësues në sistemin e arsimit para universitar regjistrohen për të marrë pjesë në konkurrim për një pozicion të lirë pune.

- Reformulime në lidhje me disa funksione kryesore të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucioneve të varësisë.
- Ndryshime në lidhje me përbërjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Para universitar.
- Përcaktime në lidhje me krijimin e Këshillit Kombëtar të Prindërve.
- Ndryshime të kritereve që duhet të plotësojnë mësuesit për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit.
- Shfuqizimin e disa dispozitave ligjore, etj.

Ligji nr. 69/2012, i ndryshuar në tërësi trajton parimet bazë të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së sistemit arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i ligjit është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, të të gjithë shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjisllacionin shqiptar.

Sistemi arsimor para universitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit, të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike, të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Disa nga aktet nënligjore në fuqi që janë miratuar në zbatim të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar janë:

Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

1. VKM nr. 662, datë 8.10.2014, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore para universitare publike”.
2. VKM nr. 682, datë 29.07.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.
3. VKM nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit para universitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar.
4. VKM nr. 98, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para universitar (ASCAP)”.
5. VKM nr. 99, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para universitar”.
6. VKM nr. 104, datë 28.2.2019, “Për përcaktimin e kritereve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”, i ndryshuar.

7. VKM nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike para universitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”.
8. VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para universitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.
9. VKM nr. 686, datë 23.10.2019, “Për kryerjen e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar.
10. VKM nr. 466, datë 10.6.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit para universitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”.
11. VKM nr. 486, datë 17.6.2020, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit para universitar”, i ndryshuar.

Udhëzime

1. Udhëzimi nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private para universitare”, i ndryshuar.
2. Udhëzimi nr. 30, datë 2.8.2013, “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”.
3. Udhëzimi nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit para universitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar.
4. Udhëzimi nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar.
5. Udhëzimi nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
6. Udhëzimi nr. 6, datë 15.4.2016, “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Vendor të Arsimit Para universitar”.
7. Udhëzimi nr. 9, datë 30.5.2016, “Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore digjitale në institucionet arsimore të sistemit arsimor para universitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës E-Learning”, i ndryshuar.
8. Udhëzimi nr. 21, datë 18.8.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”, i ndryshuar.
9. Udhëzimi nr. 26, datë 11.12.2017, “Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale”, i ndryshuar.
10. Udhëzimi nr. 12, datë 27.2.2018, “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit para universitar”, i ndryshuar.

11. Udhëzimi nr. 25, datë 25.7.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
12. Udhëzimi nr. 30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit para universitar”, i ndryshuar.
13. Udhëzimi nr. 21, datë 3.10.2019, “Për kriteret dhe procedurat për kualifikimin, trajnimin dhe certifikimin e drejtuesve në detyrë të institucioneve të arsimit para universitar”.
14. Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit para universitar”.
15. Udhëzimi nr. 2, datë 28.1.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit para universitar”, i ndryshuar.
16. Udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit para universitar”, i ndryshuar.
17. Udhëzimi nr. 21, datë 13.8.2020, “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorim falas në arsimin para universitar”.
18. Udhëzimi nr. 4, datë 26.2.2021, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
19. Udhëzimi nr. 8, datë 8.4.2021, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e medaljes së artë nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë”.
20. Udhëzimi nr. 10, datë 17.5.2021, “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore para universitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktimë të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”.
21. Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit para universitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar”.
22. Udhëzimi nr. 16, datë 28.7.2021, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
23. Udhëzimi nr. 3, datë 9.2.2022, “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit para universitar”.
24. Udhëzimi nr. 17, datë 5.7.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor para universitar”.
25. Udhëzimi nr. 20, datë 19.7.2022, “Për përcaktimin e lëndëve mësimore që zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare nga nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë në Shqipëri”.
26. Udhëzimi nr. 21, datë 27.7.2022, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e “Medaljes së Artë” nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë”.

Urdhra

1. Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore para universitare në Republikën e Shqipërisë”.
2. Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit para universitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”, i ndryshuar.
3. Urdhri nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar.

Ligji aktual në fuqi është përafuar plotësisht me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000.

Gjithashtu, ligji përafrohet pjesërisht me “Rekomandimin e Këshillit të 22 majit 2017 mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 Prillit 2008 mbi krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës” dhe “Rekomandimin e Këshillit të 28 qershorit 2011, për reduktimin e braktisjes së hershme të shkollës”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Përshkrimi i natyrës së problemit

Nevojitet përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar, duke plotësuar mangësitë e legjislacionit të hasura gjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi. Reformulimi i disa prej dispozitave ligjore, në kuadër të propozimeve të bëra nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin para universitar, në funksion të qartësisë që duhet të kenë përcaktimet ligjore.

Identifikimi i shkaqeve të problemit

Shkaku kryesor i problematikave të konstatuara është mungesa e dispozitave në ligjin aktual nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që rregullon disa raste specifike të mirëfunksionimit të sistemit arsimor para universitar. Pra zbatimi në praktikë i tij bëhet i pamundur në mungesë të disa rregullimeve specifike.

Problematikat e konstatuara janë të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim:

- ✓ mosfunksionimi efektiv në praktikë i shkollave të bashkuara. Mungesa e parashikimeve ligjore për funksionimin efektiv të shkollave të bashkuara, të cilat janë institucione arsimore para universitar publike, që përfshijnë nxënës të disa niveleve arsimore.
- ✓ mungesa e parashikimeve ligjore për funksionimin e shkollave të arsimit special, ka çuar në mosfunksionimin efektiv të qendra burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara;

- ✓ niveli pamjaftueshëm i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në gjithë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara;
- ✓ mungesa e parashikimeve ligjore për mësuesit në dispozicion në institucionet arsimore para universitare publike për zëvendësimin e mësuesve në institucione të ndryshme sipas rasteve dhe nevojave;
- ✓ mungesa e një parashikimi ligjor që ndalon personat që janë dënuar për vepra penale, që lidhen me të miturit, ose vepra penale që lidhen me institucionet arsimore para universitare, ose që figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Dënuarve për Krime Seksuale, për të ushtruar profesionin e mësuesit apo për të punuar, në institucionet arsimore para universitare, le të hapur mundësinë e punësimit të këtyre personave në sistemin arsimor para universitar
- ✓ Pamundësia për regjistrim në sistemin arsimor para universitar të nxënësve të cilët mbushin moshën 6 vjeçare deri në dhjetor të atij viti mësimor. Mungesa e një dispozite ligjore që t'ju lejojë regjistrimin këtyre nxënësve nuk i ofron mundësinë kësaj kategorie fëmijësh për ndjekjen e vitit të parë të shkollës.

Përshkrimi i shtrirjes së problemit

Problematikat në shqyrtim paraqesin një shtrirje të gjerë në fushën e arsimit para universitar, duke prekur të gjithë sistemin arsimor (mësues dhe nxënës në të gjithë Republikën e Shqipërisë). Nëpërmjet adresimit të problematikave, synohet përmirësimi i bazës ligjore që do të shërbejë për trajtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me fushën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë.

Grupet e prekura nga ky problem

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin para universitar.
2. Institucionet arsimore para universitare.
3. Qytetarët (Nxënësit dhe prindërit).
4. Punonjësit arsimorë.
5. Qeveria.
6. Grupet e tjera të interesit në varësi të rastit.

Vlerësimi nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave

Problematika e sipërcituar synohet të adresohet nëpërmjet ndërhyrjes së politikës, duke garantuar kështu përmirësimin e bazës ligjore që do të shërbejë për trajtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me fushën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Qeveria planifikon të ndërhyjë me qëllim që ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar të ndjekë të njëjtën linjë dhe të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026).

Nëpërmjet kësaj politike synohet plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor në fuqi në fushën e arsimit para universitar, duke bërë të mundur zbatimin e vizionit dhe të politikës së Qeverisë Shqiptare në këtë fushë.

Gjithashtu, kjo politikë ka si qëllim të arrijë një përafrim edhe më të madh të dispozitave të këtij ligji me legjislacionin arsimor evropian. Konkretisht, nisma e qeverisë lidhet më çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

Ligji aktual përafrohet pjesërisht me “Rekomandimin e Këshillit të 22 majit 2017 mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 Prillit 2008 mbi krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës” dhe “Rekomandimin e Këshillit të 28 qershorit 2011, për reduktimin e braktisjes së hershme të shkollës”.

Sa më sipër, ndërmarrja e kësaj politike vjen si nevojë dhe detyrim i rishikimit të rregullt të ndikimit të akteve ligjore, si dhe zhvillimit të politikave dhe të strategjive të reja sektoriale dhe ndërsektoriale në fushën e arsimit, si një e mirë publike dhe objektiv social parësor kushtetues për shtetin e së drejtës.

Riformulimi dhe shtimi i disa përcaktimeve propozohet të bëhen në funksion të qartësisë që duhet të kenë përcaktimet ligjore dhe në plotësim të disa vakumeve e problematikave ligjore të evidentuara ndër vite gjatë zbatimit të ligjit aktual nr. 69/2012, të ndryshuar.

Gjithashtu, nga analiza e problematikave të ndeshura në praktikë gjatë zbatimit të ligjit dhe pas vlerësimit të ndryshimeve që duhet të bëheshin u arrit në konkluzionin që nevojitet ndërhyrja e politikës për zgjidhjen e tyre.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat të jenë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*
- Garantimi i mirëfunksionimit dhe efikasitetit të bashkuara, të cilat janë institucione arsimore para universitare publike, që përfshijnë nxënësit të disa niveleve arsimore, brenda vitit 2024.
 - Garantimi i të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, si dhe promovimi i talenteve në arsimin bazë nëpërmjet përfshirjes së konceptit të shkollave me status të veçantë.
 - Sigurimi i mbrojtjes së nxënësve dhe integritetit të mësuesve, si dhe punonjësve të tjerë që punojnë në institucionet arsimore para universitare.

- Garantimi i të drejtës për të ndjekur arsimin bazë edhe nga fëmijët që mbushin moshën 6 vjeç pas fillimit të vitit shkollor, por brenda datës 31 dhjetor të po atij viti kalendarik.
- Garantimi i të drejtës për arsimim cilësor dhe shërbime të specializuara rehabilituese në qendra burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i figurës dhe integritetit të drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor privat, nëpërmjet konfirmimit nga institucioni përgjegjës për licencimin, sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

Opsioni 0 (status quo):

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky opsion i cili quhet ndryshe opsioni pa ndryshime do të nënkuptonte gjendjen aktuale pa asnjë ndryshim në kuadrin ligjor në fuqi. Gjendja aktuale tregon qartë se korniza ligjore në fushën e arsimit para universitar ka mangësi dhe krijon problematika gjatë zbatimit të tij.

Ky opsion nuk i zgjidh problematikat e evidentuara. Kostot dhe përfitimet për grupet e prekura do të jenë të pandryshueshme, por problemet e identifikuar nuk do të gjejnë zgjidhje, pasi nëse nuk do të ketë ndërhyrje rregullatorë situata juridike do të mbetet e parregulluar dhe problematikat e evidentuara do të mbeten të pa trajtuara sipas nevojave të sotme praktike.

Ligji aktual në fuqi lë jashtë çështje që paraqesin rëndësi në fushën e arsimit para universitar, siç janë: koncepti i shkollave të bashkuara, përfshirja e mësuesve në dispozicion në institucionet arsimore para universitare publike, krijimi i Qendrave Burimore, etj.

Opsioni 1:

Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i një ligji të ri. Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, që është aktualisht në fuqi trajton pjesën më të madhe të çështjeve të sistemit arsimor para universitar. Ndryshimet që propozohen janë të pakta dhe synojnë vetëm të përmirësojnë dhe plotësojnë disa dispozita ekzistuese, të cilat nuk do të prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual. Për këtë arsye, në kuadër të teknikës legjislativë nuk mund të zgjidhet ky opsion, sepse do të kishte kosto të madhe, të pajustificuar, krahasuar me opsionet e tjera, si dhe do të kërkonte më shumë kohë.

Opsioni 2:

Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky opsion është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe me efektiv, pasi vetëm ky opsion do të sjellë përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë. Në krahasim me opsionin 1, ky opsion ka më pak kosto. Me reflektimin e ndryshimeve në ligjin ekzistues, rezulton se ato përbëjnë më pak se 50 % të dispozitave, kështu që nuk është e nevojshme të ndërmerret nisma për propozimin dhe miratimin e një ligji të ri.

Nëpërmjet këtij opsioni realizohet zgjidhja në mënyrë thelbësore dhe përmbajtësore e problematikave të evidentuara në fushën e arsimit para universitar gjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi, pasi duke qenë se shkak kryesor i problematikave të konstatuara është mungesa e dispozitave në ligjin aktual nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që rregullon disa raste specifike të mirëfunksionimit të sistemit arsimor para universitar, duke bërë që zbatimi në praktikë i tij bëhet i pamundur në mungesë të disa rregullimeve specifike, ndërhyrja në ligjin aktual me qëllim eliminimin e këtyre vakumeve ligjore do të ishte opsioni më i mirë i mundshëm.

Ky opsion do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore që lidhen me arsimin para universitar, si dhe do të kontribuojë në integrimin e Shqipërisë në BE.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

Nëpërmjet arsimit para universitar cilësor, synohet gjithë përfshirje dhe barazi, duke krijuar kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

Grupet e prekura nga kjo politikë janë:

- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin para universitar.
- Institucionet arsimore para universitare.
- Qytetarët (Nxënësit dhe prindërit).
- Punonjësit arsimorë.
- Qeveria.
- Grupet e tjera të interesit në varësi të rastit.

Opsioni i preferuar do të ketë ndikime sociale pozitive në gjithë përfshirjen në arsim. Konkretisht, ndikimet sociale të drejtpërdrejta të grupet e prekura janë:

- Rritja e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin para universitar;
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies, kryesisht në institucionet arsimore para universitare që ofrojnë arsim special dhe shërbime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara (Qendra Burimore).
- Rritja e numrit të nxënësve që frekuentojnë Qendrat Burimore.
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor në sistemin arsimor para universitar.
- Rritja e mundësive për ndjekjen e arsimit para universitar nëpërmjet funksionimit të shkollave të bashkuara që përfshijnë nxënës të disa niveleve arsimore;
- Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të nxënësve si pasojë e marrjes së masave të mësipërme.
- Përmirësimi i cilësisë së jetës për nxënësit që preken nga ndërmarrja e kësaj politike dhe familjarët e tyre, etj.;

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit të ofruar kundrejt nxënësve me aftësi të kufizuara dhe rritja e mundësiveve për ndjekjen e arsimit para universitar nga kjo kategori nxënësish;
- Rritja e besimit tek nxënësit dhe qytetarët në përgjithësi lidhur me figurën dhe integritetin e mësuesit, drejtuesit apo punonjësve të tjerë të institucionit arsimor parashkollor privat;
- Rritja e mundësiveve për një edukim dhe arsimim të vazhdueshëm universitar për të gjithë;
- Përmirësimi i cilësisë së kushteve për mësimdhënie dhe rrjedhimisht edhe i cilësisë së mësimdhënies.

Mosndërhyrja nëpërmjet politikës, nëpërmjet këtij opsioni do të shoqërohet me ndikime sociale negative, në veçanti për fëmijët me AK, për shkollat e arsimit të orientuar, për nevojat që kanë shkollat për mësues në dispozicion etj. Ndikimet sociale, në mënyrë indirekte shoqërohen me efekte ekonomike negative, nëpërmjet rritjes së shpenzimeve.

Vënia në zbatim e opsionit të preferuar do të shoqërohet me ndikime ekonomike. Miratimi i këtij projektligji pritet të ketë ndikime direkt në buxhetin e shtetit në drejtim të rritjes së shpenzimeve, konkretisht si më poshtë:

për rritjen e numrit ekzistues të punonjësve me rreth 50%, si pasojë e krijimit të Qendrave Burimore;

- për blerjen e mjeteve didaktike mësimore;
- për trajnimin e personelit mësimor;
- për blerjen dhe pajisjen me tekste shkollore;
- për blerjen e pajisjeve laboratorike elektronike & kompjuter;
- për blerjen e pajisjeve të tjera të specializuara;
- për rindërtimin sipas standardeve evropiane të institucioneve arsimore para universitare.

Aktualisht funksionojnë 9 (nëntë) institucione arsimore që nuk kanë statusin e qendrave burimore ku standardet e mësimdhënies, numri i punonjësve, normat mësimore, punonjësit ndihmës, apo punonjësit psiko-sociale kanë një standard, ashtu si shkollat e tjera. Pas miratimit apo ndryshimeve ligjore këto 9 (nëntë) qendra burimore do të ndryshojnë tërësisht qasjen ndaj mësimdhënies, raportin punonjës – nxënës, norma mësimore, pajisjet e mësimdhënies, trajnimet, etj.

Ky ndryshim do të reflektojë në shtesën numrit të punonjësve ndihmës mësimorë, si dhe punonjës psikosociale në institucionet arsimore, shtesë e cila reflektohet dhe në efektet e pritshme financiare.

Nëse nuk reflektohen këto ndryshime rreth 1000 punonjës mësimore që aktualisht punojnë si mësues për shkak të uljes së numrit të nxënësve, uljes së numrit të klasave dhe standardeve mësimore duhet të dalin jashtë sistemit, miratimi i ndryshimeve ligjore do të bëjë të mundur shtesën numrit të punonjësve apo ndryshimin e strukturave të personelit mësimor, ndihmës mësimor dhe punonjësve psiko-sociale në këto institucione arsimore. Për këtë arsye janë përlllogaritur dhe efektet financiare që do të sjellë ky projektligji.

Konkretisht sqarojmë se për funksionimin e shkollave speciale si “Qendra burimore”, parashikohet kthimi i 9 (nëntë) institucioneve të arsimit special të sipërcituara në qendra

burimore. Në “Qendrat Burimore”, siç është përcaktuar më lart parashikohet të ketë rritje të numrit ekzistues të punonjësve me rreth 50%. Rritja e numrit të punonjësve lind nevojën për shtesë pagash në buxhet për këta punonjës shtesë. Stafit shtesë do të kryejë funksionet e qendrës burimore, vlerësim të nxënësve, shërbime të specializuara rehabilituese, trajnime dhe ndjekje, kujdes të vijuar të nxënësve me aftësi të kufizuara apo aftësi ndryshe në të gjitha institucionet arsimore të vendit. Numri i nxënësve që do të përfitojnë menjëherë drejtpërdrejtë nga krijimi, reformimi i shkollave speciale në qendra burimore është 4700 nxënës. Kjo shifër përfshin nxënësit me aftësi të kufizuara në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar publik, arsim special dhe gjithëpërfshirës. Çdo vit parashikohet një rritje mesatarisht me 5% e këtij numri të nxënësve. Me ngritjen e qendrave burimore parashikohet të ketë rritje të numrit të klasave që kanë shkollat speciale, si dhe mundësia për të vijuar arsimin e mesëm të lartë në këto institucione.

Në përlogaritjen e koston vjetore rritja mesatarisht me 5% e nxënësve që do të ndjekin këto shkolla specifike, ndaj vitit paraardhës nuk është marrë në konsideratë, pasi fondet e kursyera sipas ndryshimeve strukturore do të mbulojnë kostot e shtuara në këto nëntë institucione apo qendra burimore të krijuara. Pra, këta nxënës që pas vlerësimit do të kalojnë nga sistemi masiv arsimor në qendrat burimore do të krijojnë burime njerëzore dhe financiare “të lira” për tu rishpërndarë drejt këtyre qendrave.

- Nevojat për laboratorë, pajisje dhe mjete didaktike shtesë për 2 (dy) institutet vitin e parë do të mbulohen nga projekti IPA 2018. Në vijim sipas taveve buxhetore të miratuara do parashikohen nevojat vit pas viti. Sipas taveve buxhetore të miratuara do të financohen hap pas hapi nga fondet e buxhetit të shteti.

Vlera e miratuar për projektin sipas Kontratës “IPA 2019/AL/I Projektit EU 4 Inclusive Teaching”, për katër objektivat e projektit është 2,352,941.19 Euro. Objektivi nr. 4 i projektit është “Bashkëpunimi për hartimin e një plani tranzicioni drejt krijimit të Qendrave Burimore dhe ndërtimin e kapaciteteve për lehtësimin e zbatimit të këtij plani”, por duke qenë se në kontratë nuk ndahet në mënyrë specifike se sa është shuma për secilin objektiv, nuk mund të kemi një shumë të detajuar për objektivin 4. (Kontrata është nënshkruar nga MFE datë 30.12.2021, Zyra e Delegacionit Europian në Tiranë datë 22.02.2022 dhe zbatohet nga OSFA dhe Universiteti Tampere Finlandë).

- Përlogaritjet e efekteve financiare të krijimit të 9 (nëntë) institucioneve, në “Qendra burimore”; ku do të përfitojnë rreth 4,700 nxënës e mësues, si dhe mësues ndihmës, do të ketë një kosto financiare me rreth 50% të punonjësve parashikohet të shtohen në këto shkolla dhe më shumë se 1000 punonjës mësimore, mësimore-ndihmës, punonjës psiko-socialë me një kosto vjetore të parashikuar për shpenzime personelit, 1,000 punonjësve x 80,000 lekë *12 muaj = 960,000,000 lekë; shtuar dhe sigurimet shoqërore në masën 16.7% = 160,320,000 lekë; Totali 1,120,320,000 lekë në vit.

Sqarojmë, se numri prej 1000 punonjësish mësimore janë aktualisht në sistem dhe punojnë si mësues ndihmës. Nëpërmjet këtij projektligji synohet që ky numër punonjësish të strukturoren sipas një strukture të veçantë, pra struktura e re e Qendrave Burimore do të ketë tanimë dhe punonjës mësimore ndihmës, punonjës psiko-socialë, mjek, logopedist, si dhe punonjës apo oficer sigurie. Ristrukturimi apo ndryshimin i

strukturës së numrit të punonjësve në institucionet arsimore, Qendrave Burimore, nuk do të përbejë kosto të shtuar për buxhetin e shtetit, pasi aktualisht këto punonjës paguhen si mësues dhe pagat e tyre janë të planifikuara në fondet buxhetore. Por, në rast se nuk do të ndërmerret nisma për miratimin e projektligjit, ky numër punonjësish do të detyrohen të dalin jashtë sistemit arsimor.

- Numri i punonjësve i parashikuar si shtesë për qendrat burimore, do të jetë brenda numrit aktual të punonjësve të arsimit parauniversitar, por do të ndryshohet struktura nga punonjës mësues në ndihmës mësues, si dhe punonjës psiko-socialë.
- Fonde të parashikuara për blerje e mjeteve didaktike dhe mësimore, për shërbim cilësor në 4,700 nxënës parashikohet 9,400,000 lekë në vit.

Mjete didaktike konsiderohen mjetet në shërbim të mësuesit dhe mësimit, dhe që i shërbejnë mësuesve në kuadër të zhvillimit të lëndëve të veçanta mësimore (mjete didaktike-mësimore për zhvillimin e mësimit në lëndën gjuhë shqipe, matematikë, dituri natyre, gjeografi, histori, biologji, fizikë, kimi, edukim fizik, muzikë, etj.). Ndërsa, **mjetet mësimore** janë mjetet personale të secilit nxënë që shërbejnë për përvetësimin e mësimit dhe plotësimin e detyrave të klasës dhe të shtëpisë (fletore sipas lëndëve matematikë, gjuhë, fletore muzike, fletore vizatimit, fletore punë të ndryshme të pavarura, çanta për librat dhe mjete të punës për nxënësit sipas orëve mësimore, si lapsa, lapustila, plastelina, vizore, kompaste, raportorë, trekëndësja trupa të ndryshëm gjeometrike që përdoren në klasë apo në shtëpi nga nxënësit).

- Fonde të parashikuara për trajnimin e rreth 1000 punonjësve mësues ndihmës-mësues, punonjës psiko-socialë me një kosto vjetore të shpenzimeve të parashikuara në masën 4,000,000 lekë në vit;
- Fonde të parashikuara, për blerje dhe pajisjen me tekste shkollore, mjete shkollore dhe materiale ndihmës mësimore, përfshirë nxënësit që nuk shikojnë, për 4700 nxënës x 10,000 lekë = 47,000,000 lekë;
- Fonde të parashikuara për pagesën e bursave kuotave ushqimore për rreth 4700 nxënës parashikohet një fond $4700 \times 6,668$ lekë në muaj x 9 muaj = 282,057,034 leke në vit;
- Fonde të parashikuara “Për blerje pajisje laboratorie elektronike & kompjuter të specializuar”, për nxënësit që nuk shikojnë, për nxënësit që nuk dëgjojnë si dhe nxënësit me aftësi ndryshe përfshirë dhe mësuesit, ndihmës-mësuesit si dhe punonjësit psiko-socialë, parashikohet një fond prej 4700 nxënës + 1,000 punonjës mësues dhe ndihmës mësues x 150,000 lekë = 855,000,000 lekë për 10 vjet, ose 85,500,000 lekë në vit.
- Fonde të parashikuara, “Për ndërtimin-rindërtimin e objekteve arsimore”, dhe pajisjen e mjediseve të mjediseve të institucioneve arsimore sipas standardeve evropiane për një periudhë 9-10 vjeçare parashikohet të jetë 900,000,000 lekë, ose 90,000,000 lekë në vit.

Sa më sipër, sqarojmë se kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, janë konsideruar gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2023-2025 dhe në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2023-2025.

Gjithashtu, në parashikimin e efekteve financiare në 10 vite nuk është konsideruar niveli i ndikimit të inflacionit vjetor, pasi një pjesë e këtij ndryshimi mbulohet nga politika e rritjes së pagave sipas programit të reformave miratuar në Këshillin e Ministrave. Ndërsa për zërat e

tjerë të shpenzimeve, efektet shtesë parashikohen të mbulohet nga ndryshimet strukturore të shpenzimeve të parashikuara në arsimin parauniversitar.

Me ndryshimet e propozuara parashikohet, gjithashtu të ketë ndikime mjedisore, nga rindërtimi i institucioneve arsimore para universitare (IAP). Kryesisht rindërtimi i IAP-ve do të sjelli ndikime negative në natyrë dhe mjedis, siç mund të përmendim ndotjen e ajrit, e cila vjen si rezultat i përhapjes së pluhurave që gjenerohen nga materialet e ndërtimit. Megjithatë, duhet theksuar se aktiviteti i përditshëm urban i automjeteve gjeneron ndotje më të madhe se sa përdorimi i mjeteve në kantier.

Një tjetër ndikim mjedisor negativ mund të përmendim zhurmat që do të gjenerohen në mjediset e kantierëve të rindërtimit të IAP-ve, të cilat do të vijnë kryesisht nga mjetet dhe makineritë, si dhe nga proceset e ndryshme të rikonstruksionit, ndërtimit, etj. Por, të gjitha këto efekte negative do të jenë të përkohshme, deri në rindërtimin e IAP-ve dhe do të jenë në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës për grupe/kategori të caktuara popullsie dhe efektet pozitive i tejkalojnë këto efekte të përkohshme negative në mjedis.

Rindërtimi i IAP-ve mund të sjellë edhe ndikime pozitive, ndër të cilat mund të përmendim përmirësimin e peizazhit të zonës.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2 “ndryshimi i ligjit aktual, nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, me qëllim harmonizimin me legjislacionin që prek çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut, bazuar në analizën e dispozitave që duheshin ndryshuar. Me reflektimin e ndryshimeve në ligjin ekzistues, rezulton se ato përbëjnë më pak se 50 % të dispozitave, kështu që nuk është e nevojshme të ndërmerret nisma për propozimin dhe miratimin e një ligji të ri.

Ky opsion është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe me efektiv, pasi vetëm ky opsion do të sjellë përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë, me një kosto më të ulët dhe një përtim më të madh.

Për të dhënë një ide më të qartë të arsyeve së përzgjedhjes së Opsionit 2 si opsioni i preferuar për implementimin e politikës, është përgatitur analiza me shumë kriterë.

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kriterë janë:

Opsioni 0: - Ruajtja e status *quo*-së, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues;

Opsioni 1: - Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 2: - Ndryshimi i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. Efektiviteti në garantimin e të drejtës për arsimim cilësor dhe shërbime të specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuara.
2. Efikasiteti në krijimin e shkollave me status të veçantë për sigurimin e të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv.
3. Krijimi i kushteve të favorshme dhe efikase për sigurimin e mbrojtjes së nxënësve dhe integritetit të mësuesve, si dhe punonjësve të tjerë që punojnë në institucionet arsimore para universitare.
4. Qartësimi e kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar;
5. Kosto – efektiviteti.

Është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Efektiviteti në garantimin e të drejtës për arsimim cilësor dhe shërbime të specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuara; - 5
2. Efikasiteti në krijimin e shkollave me status të veçantë për sigurimin e të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv; - 4
3. Krijimi i kushteve të favorshme dhe efikase për sigurimin e mbrojtjes së nxënësve dhe integritetit të mësuesve, si dhe punonjësve të tjerë që punojnë në institucionet arsimore para universitare; 5
4. Qartësimi e kuadrit ligjor në fushën e arsimit para universitar; -3
5. Kosto – efektiviteti. 3

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5;

Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës:

<u>Kriteret</u>	<u>Pesha (Rëndësia relative)</u>	<u>Opsioni 0</u>		<u>Opsioni 1</u>		<u>Opsioni 2</u>	
		<u>Pikë</u>	<u>Vlera (=Pesha x pikë)</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera (=Pesha x pikë)</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera (=Pesha x pikë)</u>
Efektiviteti në garantimin e të drejtës për arsimim cilësor dhe shërbime të specializuara për	<u>5</u>	<u>2</u>	<u>10</u>	<u>5</u>	<u>25</u>	<u>5</u>	25

nxënësit me aftësi të kufizuar.							
Efikasiteti në krijimin e shkollave me status të veçantë për sigurimin e të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv.	<u>4</u>	<u>2</u>	8	<u>5</u>	<u>20</u>	5	<u>20</u>
Krijimi i kushteve të favorshme dhe efikase për sigurimin e mbrojtjes së nxënësve dhe integritetit të mësuesve, si dhe punonjësve të tjerë që punojnë në institucionet arsimore parauniversitare.	<u>5</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>5</u>	<u>25</u>	<u>5</u>	<u>25</u>
Qartësimi i kuadrit ligjor në fushën e arsimit parauniversitar.	<u>3</u>	<u>1</u>	<u>3</u>	<u>5</u>	<u>15</u>	<u>5</u>	<u>15</u>
<u>Kosto - efektiviteti</u>	<u>3</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>2</u>	<u>6</u>	<u>4</u>	<u>12</u>
<u>Pikët totale për secilin opsion</u>		-	<u>21</u>	-	<u>91</u>		<u>97</u>

Analiza me shumë kritere tregon se opsioni 2, ndryshimi i ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vlerësuar me më shumë pikë, për këtë arsye është përzgjedhur si opsion i preferuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Strukturat qendrore dhe vendore të arsimit do të jenë strukturat kryesore të ngarkuara me përgjegjësinë e zbatimit të këtij projektligji, të cilat janë si më poshtë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Qendra e Shërbimeve Arsimore;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- Zyrat Vendore të Arsimit Para universitar;
- Institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Qendrat Burimore;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Disa nga pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur, janë:

- Vonesat në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjorë të cilat do të dalin në zbatim të ligjit.
- Vonesat në krijimin e Qendrave Burimore, si institucione të arsimit para universitar që ofrojnë arsim special dhe shërbime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Vonesat në identifikimin e personave të dënuar për vepra penale, që lidhen me të miturit, ose vepra penale që lidhen me institucionet arsimore para universitare, ose që figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Dënuarve për Krime Seksuale, të cilët ushtrojnë profesionin e mësuesit.
- Vonesat në rekrutimin e drejtuesve të Qendrave Burimore, si dhe punonjësve të specializuar në aftësinë e kufizuar, si mësues të arsimit special, mjekë, punonjës të shërbimit psikosocial, terapistë, që ofrojnë shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe në shkollat e zakonshme, etj.

Disa nga masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës, janë:

- Miratimi i akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur zbatimin e opsionit të preferuar.
- Ndalimi për të ushtruar profesionin apo për të punuar në institucionet arsimore para universitare, pavarësisht rehabilitimit, të personave që janë dënuar për vepra penale, që lidhen me të miturit, ose vepra penale që lidhen me institucionet arsimore para universitare, ose që figurojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Dënuarve për Krime Seksuale.
- Përcaktimi i shkollave të arsimit të orientuar që marrin statusin “Shkollë me status të veçantë”.
- Vendosja e kriterit që drejtori i institucionit arsimor parashkollor privat, konfirmohet nga institucioni përgjegjës për licencimin, sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij, etj.
- Përcaktimi i dispozitave ligjore për pranimin, emërimin, pezullimin dhe largimin nga një vend pune për mësuesin në dispozicion.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Strukturat që ngarkohen drejtpërdrejtë me vlerësimin e efektivitetit dhe të zbatimit të këtij projektligji, janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Qendra e Shërbimeve Arsimore;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Si tregues për matjen e arritjes së qëllimit, mund të përmendim, ngritjen e qendrave burimore, vënien e mësuesve në dispozicion, krijimin e shkollave kombëtare etj., konkretisht si më poshtë:

1. Numri i qendrave burimore që parashikohet të ngrihen brenda vitit 2025. Janë planifikuar për t'u ngritur rreth 9 (nëntë) të tilla.
2. Numri i mësuesve në dispozicion brenda vitit 2025. Ky kriter lidhet me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar që do të ndjekin arsimin parauniversitar. Norma përkatëse është 2-3 nxënës për mësues ndihmës në shkollat e zakonshme, ndërsa për qendrat burimore ende nuk është përcaktuar.
3. Numri i mësuesve që do t'ju ndalohej ushtrimi i profesionit të rregulluar të mësuesit për shkelje që parashikohen në projektligj.
4. Numri i nxënësve që mbushin moshën 6 (gjashtë) vjeç brenda muajve tetor-dhjetor dhe që regjistrohen për ndjekjen e klasës së parë të arsimit parauniversitar.

Ministria e Arsimit dhe Sportit vlerëson zbatimin e politikës në bazë të raporteve periodike (6 mujore e vjetore) të hartuara dhe të paraqitura nga:

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar për plotësimin e dokumenteve kurrikulare (plane mësimore, udhëzues etj.) për qendrat burimore dhe të shkollave me status të veçantë;
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar për krijimin dhe funksionimin e shkollave me status të veçantë dhe ngritjen dhe efektivitetin e qendrave burimore;
3. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Para universitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar për efektivitetin e zbatimit të ligjit nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private dhe Qendrat Burimore.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar do të monitorojë dhe do të vlerësojë zbatimin e politikës nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Para universitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore para universitare publike e private nëpërmjet inspektimeve dhe raporteve përkatëse.

Numri i raporteve të inspektimeve nga DPAP-ja do të varet nga planifikimi që do të bëjë drejtoria në varësi të tematikës dhe llojit të inspektimeve. Norma e përafërt është që çdo institucion arsimor para universitar të inspektohet me inspektim të plotë ose tematik të paktën 1 (një) herë në 4 vjet. Mesatarisht do të hartohen 350 raporte në vit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

në milionë lekë

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638	1,638
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	27	27	27	27	27	27	27	27	27	27
Kosto në total	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665	1,665

Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlera aktuale e kostos në total	16,652									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	- 16,652									

Shënim: Kosto - Përfitime

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1_Financimi me fonde nga Buxheti i shteti dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore	0	0	0
Opsioni 2	16,652	0	16,652